

Bazuar ne Statutin e Porsche Leasing Sh.p.k., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me adrese: Autostrada Tirane-Durres Km. 7, Rr. Monun, Tirane, regjistruar me NIPT L31623006N (ne vijim referuar si “**Shoqeria**”), ne perputhje me dispozitat e Ligjit per Qirane Financiare (ligji nr. 9396, date 12 Maj 2005, i ndryshuar), si dhe me Vendimin Nr. 1651, date 17 Mars 2020, te Bankes se Shqiperise, Administratoret e Shoqerise, vendosen sot me 26 Mars 2020, si me poshte:

TE OFROJE SHTYRJEN E AFATIT TE PAGESES SE KESTEVE MUJORE TE QIRASE FINANCIARE, PA APLIKUAR KAMATEVONESE, PER TE GJITHE KLIENTET E PREKUR NGA MASAT ADMINISTRATIVE KUFIZUESE per PARANDALIMIN E PERHAPJES SE METEJSHME TE VIRUSIT COVID-19.

Te gjithë klienteve, qofshin ata individe apo persona juridike, qe kane lidhur me Shoqerine kontrate(a) te qirase financiare qe jane ne fuqi, te cilet jane ndikuar negativisht nga pandemia COVID-19, Shoqeria u ofron shtyrjen deri ne 90 (nentedhjete) dite te pageses se kesteve mujore sipas kontratave perkatese ne fuqi. Oferta eshte e vlefshme per faturat e emetuara nga Shoqeria ne Mars, si dhe per faturat qe Shoqeria do te emetoje gjate muajve Prill dhe Maj 2020. Shtyrja e pageses se kesteve nuk do te ndikojne ne maturimin per Qershorin dhe muajt ne vijim, qe do vijojne te faturohen rregullisht. Vetem pasi Shoqeria te konfirmoje qe klienti permbush kriteret e perfitimit te ofertes, shtyrja e kesteve do te konsiderohet ndryshim i kushteve te pageses qe duhet dokumentuar me marreveshje me shkrim mes klientit dhe Shoqerise brenda muajit Shtator 2020 e cila i bashkengjitet kontrates perkatese te qirase financiare.

Nese klienti ka interes te perfitoje oferten e mesiperme, duhet te plotesoje formularin e kerkeses me informacionin perkates dhe shpjegimin e veshtiresive qe po has per shkak te masave administrative kufizuese per parandalimin e perhapjes se metejshtme te virusit COVID-19, si dhe nevojten per shtyrje te pageses se kestit mujor.

Klienti mund ta shkarkoje formularin e kerkeses ne www.porscheleasing.al. Pasi ta plotesoje, klienti duhet t’ia dergoje Shoqerise ne nje nga menytrat e meposhtme, cilado qofte e pershtatshme:

- nepermjet sherbimit postar ne adresen tone zyrtare: Porsche Leasing Shpk, Autostrada Tirane-Durres Km.7, Rr. Monun, Tirane, dhe/ose
- me e-mail ne adresen: info@porscheleasing.al

Shoqeria do ta perpunoje kerkesen dhe do t’i ktheje pergjigje klientit, brenda 3 diteve nga marrja e kerkeses, duke e informuar klientin nese perfiton shtyrje te pageses se kesteve.

PORSCHE LEASING SHPK